



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1457/9 prot:

Pukë, më 16.02.2024

VENDIM

Nr. 03 datë 16.02.2024

PER:

“Për hapjen e një rruge në fshatin Meçe Bashkia Pukë”

Mëshetur në ligjin 139 dt 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”i ndryshuar neni 8, neni 9, neni 20, neni 23, neni, 54. Dhe ligjit nr 9270 date 29.07.2004 i ndryshuar, Ne VKM nr 1423 datë 10.10.2008”Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Pukë të Qarkut Shkodër”.

Si dhe dhe nisur nga kërkesa e banorve të fshatit Meçe për hapjen e rrugës në fshatin Meçe Njesia Administrative Rrape Bashkisë Pukë. Fshatin Meçe ne parcelen ku propozohet hapja e rrugës ku referuar proces-verbalit të dëgjeses publike dhe shkresës së Këshillit Bashkiak rezulton se është arritur dakortësia për hapjen e rrugës :

VENDOSI:

1. Të miratohet me vendim Keshillit Bashkiak hapjen e rrugës sipas plan vendosjes .
2. Shpallur me datë **16.02.2024**
3. Miratuar me 9 vota; Vota Pro 9, Vota Kundër 0, Vota Abstenim 0 .

SEKRETARE

Edona **HYSENAJ**

KRYETARI I KESHILLIT

Eduard **GJOKA**





REPUBLICA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.172/1prot.

Shkodër, më 28.02.2024

Lënda: Mbi vendimin Nr.3 datë 16.02.2024 të Këshillit të Bashkisë Pukë.

KËSHILLIT TE BASHKISE PUKE

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8 germa a, neni 16, ligjit Nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore” ndryshuar, neni 9 pika 1.2, germa a, dhe c, neni 64 germa c, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, VKB Pukë Nr.14 datë.30.06.2020 “Mbi miratimin e rregullores se Brendshme te Këshillit Bashkiak Pukë”, Dokumentacionit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Pukë Nr.203/1prot datë.8.02.2024 “Njoftim për mbledhjen e radhes te keshillit bashkiak Puke”, Procesverbal i mbledhjes së Keshillit të Bashkiak Puke datë.9.02.2024, Nr.203/3prot datë.9.02.2024, **shqyrtoi vkb Pukë Nr.3 dt.16.02.2024: “Mbi hapjen e rrugës në fshatin Meçe, NJAD Rrape, Bashkia Pukë”**. Pas trajtimit të VKB Pukë Nr.3 datë 16.02.2024 dhe materialit bashkëlidhur, *nuk jane respektuar detyrat e lena në shkresën e Prefektit Nr.821/1prot date.25.12.2023.*

si me poshtë :

- Nuk është shoqëruar materiali me certifikatën e pronësisë, ose në mungesë të saj statusi juridik nga ASHK-ja, referuar Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, *duke mos saktësuar dhe certifikuar pronen e trajtuar.*
- Nuk i jeni referuar VKM Nr.888 date.27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorise se perdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor/kombëtar apo zgjerimin e tyre”, në Raportin teknik-ekonomik nr.1511/2prot date.19.09.2023 “Mbi studimin teknik-ekonomik për dhënie në përdorim nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqeve në pronësi publike të Bashkise Pukë”, ku trajtohet ngastra Nr.103 në ekonomine pyjore/kullorore “Krrab-Bushat” sipas (pjesë) e VKM Nr.433 datë.8.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave dhe bashkive” të ndryshuar.
- Nuk është respektuar neni 53 i VKB Pukë Nr.14 datë.30.06.2020 “Mbi miratimin e rregullores se Brendshme te Këshillit Bashkiak Pukë”, pasi VKB Pukë Nr.3 dt.16.02.2024 titullohet: “Mbi hapjen e rrugës në fshatin Meçe, NJAD Rrape, Bashkia Pukë”, ndërsa projekt-vendimi, njoftimi i mbledhjes të Këshillit Bashkiak Nr.203/1datë.8.02.2024, dhe procesverbali i mbledhjes Nr.203/3 datë.9.02.2024 titullohen: “Rishqyrtim i vkb nr.40 datë.6.12.2023 “Për hapjen e një rruge në fshatin Meçe, Bashkia Puke”, duke konfuzuar objektin e vendimarrjes të trajtuar nga këshilli, Bashkiak Pukë.

Sa më sipër, Prefekti nuk ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore. Duke ju falënduar për bashkëpunimin

